



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR 2010

Janar 2011

SHKURTIME

CEB	Banka e Këshillit të Europës
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
BB	Banka Botërore
EBRD	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EIB	Banka Europiane e Investimeve
IDB	Banka Islamike e Investimeve
GoA	Qeveria Shqiptare
KGK	Komiteti i Granteve Konkurruese
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
MIS	Sistemi Menaxhimit të Informacionit
NQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
PNMZM	Plani i Ndjekjes së Masave Zbutëse mbi Mjedisin
PZHL	Plani i Zhvillimit Lokal
CES	Consulting Engineers Salzgitte
RI	Roughton International
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulencës Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)

Pasqyra e lëndës

1. PËRMBLEDHJE.....	4
2. RAPORTI I AKTIVITETIT	7
2.1 Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri”	9
2.2 Programi “Punët në komunitet III” financuar nga CEB.....	21
2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW	27
2.4 Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare.....	30
2.5 Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA 2009)	30
2.6 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastruktues Vendore.....	31
3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL	32
3.1 Menaxhimi Financiar	32
Të ardhurat e FSHZH-së	32
Disbursimi i Fondeve gjatë 2010 sipas Programeve	33
Te ardhura të tjera	33
Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2010.....	33
Asistenca Teknike.....	35
3.2 Komunikimi dhe Informimi.....	38
3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi.....	40
3.4 Auditimi i brendshëm	43
4. AKTIVITETE TË TJERA.....	46
4.1 Përmirësimi i Strukturës Organizative të FSHZH-së.....	46
4.2 Përgatitja e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të FSHZH-së.....	48
4.3 Misionet e Vlerësimit të Bankës Botërore për Projektin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”	48
4.4 Misioni i Vlerësimit të Bankës së Këshillit të Europës për Projektin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.	49
4.5 Misioni i Vlerësimit të Bankës së Këshillit të Europës për Programin, “Punët në Komunitet III”.	49
4.6 Misionet e Vlerësimit të KfW për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”.49	49
5. ANEKSE	50
5.1 Informacion mbi nën-projektet e programit “Punët në komunitet III” Faza I & Faza II	51
5.2 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka Botërore & GoA (IDA)	55
5.3 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID.....	55
5.4 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka e Këshillit të Europës	56
5.5 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytësore & Lokale”, financuar nga IPA 2008 (CEB)	58
5.6 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytësore & Lokale”, në proces tenderimi të ndara sipas Donatoreve	59
5.7 Informacion mbi nën-projektet e programit “Ujesjellesit Rurale”, financuar nga KfW	60
5.8 Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2010 (sipas donatoreve).....	61
5.9 Shpenzimet sipas Donatoreve dhe Kategorive për vitin 2010	63
(Euro)	63
5.10 Të dhëna të transmetimit televiziv sipas Qarqeve	56
5.11 Projekte në implementim gjatë vitit 2010.....	57
5.12 Harta treguese e nënprojekteve në zbatim nga FSHZH për vitin 2010.....	89

1. PËRMBLEDHJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë vitit 2010 është angazhuar intensivisht në përbushjen e misionit të tij për nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv në nivel rajonal dhe lokal.

Gjatë vitit 2010 Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka mbështetur dhe asistuar me fonde investimi NJQV-të dhe komunitetet për rehabilitimin e infrastrukturës dhe përmiresimin e qeverisjes nëpërmjet projekteve të infrastrukturës rrugore dytësore dhe lokale, projekteve të ujësjellës-kanalizimeve, projekteve komunitare etj. Programet e investimeve për periudhën 2009-2010 kanë qenë: “Programi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, “Programi i Ujësjellësve rurale” dhe “Programi i Puneve në Komunitet III”.

Volumi i investimeve, fondeve të levruara si edhe vleresimet maksimale të marra nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, e bëjnë vitin 2010 një ndër vitet më të sukseshme të këtij institucioni që nga krijimi i tij.

Në përfundim të vitit buxhetor, ecuria e programeve paraqitet shumë e mirë duke treguar një planifikim dhe realizim efikas financiar dhe një zbatim të kënaqshëm të punimeve të infrastrukturës. Performanca institucionale ka qenë në nivele të larta duke ofruar një menaxhim eficient dhe cilësor. FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 49 milionë USD dhe ka në zbatim 77 kontrata të punimeve civile. Buxheti i vitit 2010 përfaqëson një rritje prej 30 % në raport me vitin 2009 dhe është 2,5 herë më i lartë se mesatarja historike e institucionit.

Në kuadër të Programit “**Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale**”, fundi i vitit 2010 shënoi financimin e 66 segmenteve të rrugëve dytësore dhe lokale, me një gjatësi totale prej 603 km. Në vitin 2010 ky program është konsoliduar dhe ka hyrë në një fazë intensive të zbatimit të projekteve, ndërkohë që është punuar shumë për përgatitjen e projekteve për dy vitet në vijim.

Programi “**Punët në Komunitet III**”, paraqet gjithashtu një ecuri shumë të mirë në të gjithë komponentët e tij. Ecuria shumë e mirë e këtij Programi është konfirmuar edhe nga 2 Misionet e Bankës së Këshillit të Europës, të kryera gjatë këtij viti.

Programi “**Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale**” ka hyrë në fazën e tenderimit të punimeve civile dhe faza e përgatitjes së projekteve teknike është drejt përfundimit. Gjatë vitit 2010, KfW kreu dy misione vlerësimi të programit, të cilat vunë në dukje ecurinë shumë të mirë të tij deri në këtë fazë të zbatimit.

Krahas punës së kryer për realizimin me efikasitet të këtyre programeve, FSHZH, në funksion të detyrës së tij, ka zbatuar me sukses investime në infrastrukturë me financim të drejtpërdrejtë të buxhetit të shtetit, si dhe ka vazhduar punën për asistimin teknik të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi “**Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale**” paraqet tregues shumë të kënaqshëm në të gjithë komponentët e tij. Deri në fund të vitit 2010 u financuan 66 segmente rrugore, me një gjatësi totale prej 603 km. Janë përfunduar 19 segmentet e para rrugore, me një gjatësi prej 182 km, dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 23 segmentet e tjera rrugore ose 187.5 km.

Janë në proces tenderimi 24 rrugë të tjera dytësore dhe lokale me një gjatësi totale prej 233 km, dhe në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik 49 segmente të tjera rrugore në të gjithë vendin.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të këtij programi, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit. Misioni i vlerësimit të Bankës Botërore që realizoi vlerësimin afatmesëm të ecurisë së projektit (një vlerësim i plotë dhe i gjithanshëm i të gjithë treguesve të projektit), në Dhjetor 2010, vuri në dukje se: “Ecuria e Projektit Rrugët Dytësore e Lokale mbetet në statusin shumë të mirë, dhe të gjithë treguesit e progresit të vitit të pestë të projektit janë arritur që në vitin e tretë të tij.”

Ecuria e financimit ka treguar progres dhe rezulton që deri në Dhjetor 2010 janë në proces zbatimi 296 milionë USD. Përveç fondeve të trashëguara nga 2009-ta dhe në implementim gjatë vitit 2010, u aprovua nga Kuvendi i Shqipërisë një kredi prej 50 milionë Euro nga EBRD, dhe 50 milionë Euro nga EIB, si pjesë e një pakete prej 137 milionë Euro ose 180 milionë USD financuar edhe nga IPA 2010-2011 dhe Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Banka Islamike për Zhvillim (IDB), është bërë gjithashtu pjesë e grupit të donatoreve që financojnë programin me 40 milionë USD. OFID ka financuar për herë të dytë këtë program me 10 milionë USD.

Në muajin Dhjetor 2010, u nënshkrua marrëveshja me KfW, për financimin e Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale, dhe Programin e Ujësullësave Rurale, në vlerën 20 milionë Euro. Këtij financimi i është bashkuar dhe IPA 2009, me shumën 8.8 milionë Euro.

Pjesë e grupit të donatorëve që janë angazhuar për t’iu bashkangjitur programit është edhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, JICA, IPA 2010 – 2011, etj.

Si rezultat i suksesit të implementimit të këtij programi dhe interesit në rritje të donatorëve, është tejkaluar ndjeshëm, shuma e parashikuar prej 400 milionë USD.

Programi “**Punët në Komunitet III**”, i financuar nga CEB, paraqet një ecuri të kënaqshme në të dy komponentët e tij, asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve dhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës.

Ky projekt ka orientuar drejt një zhvillimi të qëndrueshëm 16 komuna, duke i pajisuar ato me Plane Zhvillimi, si edhe duke i mbështetur këto plane me projekte të rëndësishme infrastrukturore.

Investimet mbështetëse në infrastrukturë kanë realizuar 37 nën-projekte, janë në zbatim 6 nën-projekte dhe 2 të tjerë në fazën e kontraktimit dhe prokurimit.

Projekti i III-të i punëve në komunitet sjell një risi në fushën e veprimtarisë së FSHZH-së duke ofruar strategji konkrete që orientojnë investimet e FSHZH-së por mbi të gjitha ato të vetë komunave drejt qëllimeve strategjike e ndërhyrjeve të studiuara, që nxisin zhvillimit ekonomik në nivele afatshkurtra dhe afatmesme.

Programi “**Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale**”, gjatë këtij viti ka hyrë me sukses në fazën e implementimit të tij. Në fund të muajit Dhjetor 2010, janë shpallur tenderat për kryerjen e punimeve civile për 3 skemat e para. Është drejt përfundimit faza e hartimit të

projekteve teknike dhe ka përfunduar me sukses fushata e informimit, mobilizimit dhe sensibilizimit të komunitetit.

Gjatë këtij viti është kontraktuar Projektimi & Supervizioni për 28 skema të ujësjellësave të ndara në katër lote. Deri në Dhjetor 2010, janë dorëzuar 21 projekte teknike, dhe pritet që fillimi i vitit 2011, të shënojë edhe përfundimin e projekteve teknike për 5 skema të tjera. Ndërkohë fushata e informimit, mobilizimit dhe sensibilizimit të komunitetit duke konkluduar në ngritjen e 26 Grupeve të Përfituesve të Ujit në nivel fshati dhe komune.

Menaxhimi financiar gjatë këtij viti ka garantuar ekuilibrat financiarë duke mbajtur aktivitetin ekonomik - financiar të organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit e mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponenteve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Gjatë vitit 2010, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 49 milionë USD ose në masën 93% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar. Gjatë këtij viti është ndjekur zbatimi i 77 kontratave për punime civile me vlerë rreth 10 miliardë Lekë, kryesisht rrugë. Pjesën më të madhe rreth 8 miliardë Lekë e zenë kontratat e lidhura në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe rreth 2 miliardë Lekë kontratat e lidhura në kuadër të Projektit të Punëve në Komunitet III.

Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Në një vështrim të përgjithshëm ky ka qenë në vit mjaft i rëndësishëm për institucionin, vit i menaxhimit të një buxheti të rritur ndjeshëm, por edhe një vit intensiv negociatash e parapërgatitjeje për sfidat e një aktiviteti me volum pune të dyfishuar për vitin 2011 e vitet në vazhdim. Gjatë këtij viti gjithashtu, është diskutuar rreth strategjisë afat-mesme të institucionit. Kemi në dorë një studim paraprak që hap shtegun për diversifikimin e mbështetjes së ofruar nga FSHZH për qeverisjen vendore në vitet në vijim. FSHZH edhe këtë vit është konfirmuar si një aktor i rëndësishëm në implementimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe lokal duke paraqitur një vizion të qartë, metodologji dhe staf profesional dhe duke përbushur të gjithë objektivat e saj vjetor dhe institucional.

2. RAPORTI I AKTIVITETIT

Investimet në infrastrukturë zënë peshën kryesore të aktivitetit institucional të FSHZH. Gjatë vitit 2010, FSHZH është angazhuar në një total prej 186 nën-projektsh të infrastrukturës rurale, me një shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse.

Pjesën kryesore të këtyre investimeve e zënë rrugët dytësore & lokale, ujësjellësat dhe kanalizimet, projektet e ndërtimit dhe rehabilitimit të objekteve turistike, etj.

Deri në 31 Dhjetor 2010 kanë përfunduar punimet 56 nënprojekte dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 30 nënprojekte të tjera. Ndërkohë janë në proces tenderimi ose kontraktimi 29 nënprojekte, dhe janë në përfundim të procesit të përgatitjes së dokumentacionit 71 nënprojekte të tjera. Këto të fundit janë pjesë e financimit të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, dhe Programit të Ujësjellësve Ruralë.

Një vëmendje e vecantë i është kushtuar rritjes së cilësisë së projektimit, dhe respektimit të standarteve të parashikuara. Të gjitha projektet teknike të objekteve në zbatim, kontrollohen dhe miratohen nga stafi i Departamentit të Infrastrukturës, duke rritur ndjeshëm efektivitetin e këtij procesi.

Zbatimi me cilësi i punimeve dhe rritja e standarteve teknike të aplikuara, është një nga prioritetet institucionale të cilit i është kushtuar një vëmendje e vecantë. Vlen për tu përmendur fakti se në Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale”, janë duke u zbatuar standartet e zbatimit dhe supervizimit të punimeve sipas FIDIC.

Supervizimi i punimeve për objektet në zbatim, është duke u kryer nga kompani ndërkombëtare dhe vendase me eksperiencë në këtë fushë. Aplikimi i standarteve të larta në supervizimin e punimeve ka sjellë rezultate mjaft të kënaqshme në realizimin me cilësi të punimeve.

Mjedisi, dhe zbatimi i procedurave për ruajtjen e tij ka shoqëruar në çdo moment punën për zbatimin e investimeve në infrastrukturë. Ndjekja me kujdes e këtij komponenti ka bërë të mundur respektimin me rigorozitet të parametrave mjedisorë duke aplikuar kështu me sukses një nga parimet themelore të punës në këtë institucion.

Tabela 1. Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2010

Donatori	Plani i Punës (PP)	Totali	Projekte ne fazen e pergatitjes se dokumentacionit	Në tenderim	Në kontraktim	Në zbatim	Në Garanci	Mbyllur Përfundimisht në 2010
CEB (CW III)	PP I – IV	45		1		7	23	14
GOA 2009	PP 1	2					1	1
KFW (SIF II & III)	PP 1	31					1	30
KFW (RWS)	PP 1	26	22	4				
IDA GOA	PP 1	4				1	3	
OFID (OPEC)	PP 1	7					7	
CEB SLRP	PP 1 & PP 2	30		3		18	9	
IPA 2008	PP 1	4				4		
IDB SLRP	PP 1	13	9	4				
EBRD & EIB SLRP	PP 1	19	5	14				
OFID (OPEC II)	PP 2	3		3				
Te tjera SLRP		35	35					
TOTALI		219	71	29	0	30	44	45

2.1 Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri”


Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, bashkëfinancuar nga Banka Botërore dhe Donatorë të tjerë në vlerën 400 milionë USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si dhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rreth 1500 km rrugë.

Programi deri në Dhjetor 2010, është financuar në shumën 296 milionë USD dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij.

Donatori	Financim (milione USD)
BB	20
OFID (OPEC)	25
GoA	9
CEB	56
IPA 2008	11
BERZH	67.5
BEI	67.5
IDB	40
Total	296

Deri në muajin Dhjetor 2010, FSHZH ka financuar 66 segmente rrugësh dytësore & lokale me një gjatësi totale prej 603 km. Nga këto deri në fund të muajit Dhjetor 2010, janë përfunduar 19 segmentet e para rrugore, me një gjatësi prej 182 km, dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 23 rrugë me një gjatësi prej 187.5 km. Janë në proces tenderimi 24 rrugë të tjera dytësore dhe lokale me një gjatësi totale prej 233 km. Ndërkohë janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik 49 segmente të tjera rrugore në të gjithë vendin.

Në fazën e parë janë hartuar projektet teknike, prokuruar dhe kanë filluar punimet në segmentet rrugore të financuara nga BB, Qeveria Shqiptare dhe OFID. Me këto fonde janë financuar 11 projekte për akset rajonale me të rëndësishme të vendit në një gjatësi prej 110 km. Në fund të muajit Dhjetor 2010, kanë përfunduar punimet në 10 segmente rrugore, ose 98.5 km.



Në fazën e dytë është vënë në efikasitet edhe fondi prej 40 milionë Euro financuar nga Banka e Këshillit të Europës (CEB) me të cilin janë financuar 27 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 225.5 km. Nga këto, 9 segmente rrugore kanë përfunduar dhe janë në zbatim 19 segmente të tjera rrugësh. Kjo fazë ka filluar nga zbatimi në Qershor 2009, dhe punimet janë në vazhdimësi.

Nga këto 27 segmente rrugore, 9 projekte kanë filluar zbatimin e tyre gjatë muajve Qershor – Korrik 2010.

Katër segmente, rreth 34 km rrugë janë financuar nga Programi IPA'08. Për këto segmente procedurat janë të centralizuara, pra prokurimi dhe supervizimi i punimeve janë organizuar nga vetë Delegacioni i Bashkimit Europian. Gjatë vitit 2010, ka përfunduar procesi i përzgjedhjes së kompanisë së supervizimit, dhe tenderi i përzgjedhjes së kontraktorëve për zbatimin e punimeve. Në fund të muajit Shkurt 2010, janë lidhur kontratat, dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në terren. Në muajin Shtator 2010, është miratuar edhe një shtesë kontrate për 3,5 km të cilat janë pjesë e rrugës "Ish SMT – Rrilë – Shënkoll".

Gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2010, përfundoi procesi i përgatitjes së dokumentacionit teknik për 24 rrugë dytësore dhe lokale. Përfundimi i këtij procesi i la vend, shpalljes së tenderave për punime civile. Ky proces është në vijim e sipër dhe pritet që gjatë muajve të parë të vitit 2011, të bëhet shpallja e fituesve, dhe të fillojë në terren zbatimi i punimeve. Këto segmente rrugore janë financuar nga IDB, OFID (II), EBRD dhe EIB.

Në Janar 2010 një delegacion i Ministrisë së Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, zhvilloi negociatën me Bankën Europiane për Rindërtim e Zhvillim (EBRD) për sigurimin e një kredie në kuadër të financimeve të donatorëve për programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale. Në vijim u nënshkruan marrëveshjet e financimit të këtij programi nga EBRD në vlerën 50 milionë Euro ose 67.5 milionë USD, dhe EIB në vlerën 50 milionë Euro ose 67.5 milionë USD.

Kredia prej 50 milionë Euro nga EBRD është pjesë e një projekti të koordinuar prej 137 milionë Euro që do të mbështesë programin e "Rrugëve Dytësore dhe Lokale". Programi është bashkëfinansim me Bankën Europiane të Investimeve me 50 milionë Euro dhe me grante të Bashkimit Europian nga IPA 2010 e 2011 me shumën prej 33 milionë Euro. Një grant prej 4 milionë Euro nga Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor do të mbulojë koston e tjera të lidhura me projektin si projektim-supervizim, asistencë teknike etj. Rreth 650 km rrugë dytësore dhe lokale parashikohet të rindërtohen nga financimet e mësipërme gjatë 5 viteve të ardhshme.

Në kuadër të financimit të Programit "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale", në Shtator 2010, Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi marrëveshjen e huasë me Bankën Islamike për Zhvillim (IDB), për financimin e 40 milionë USD. Këtij financimi të IDB-së, i është bashkuar edhe Qeveria e Shqipërisë me 4 milionë USD. Gjithashtu OFID është bërë për të dytën herë, pjesë e financimit të Programit, me 10 milionë USD. Marrëveshjet e nënshkruara së fundmi, e cojnë vlerën e deritanishme të financimit të programit në 296 milionë USD. Në muajin Dhjetor 2010, u nënshkrua marrëveshja me KfW, për financimin e Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale, dhe Programin e Ujësjetësive Rurale, në vlerën 20 milionë Euro. Këtij financimi i është bashkuar dhe IPA 2009, me shumën 8.8 milionë Euro.

Pjesë e grupit të donatorëve që janë angazhuar për t'iu bashkangjitur programit është edhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, JICA, IPA 2010 – 2011, etj.

Ecuria e deritanishme e projektit

Komponentët kryesorë të projektit dhe ecuria e secilit prej tyre janë si më poshtë:

Komponenti i parë: Financimi i aktiviteteve mbështetëse të programit:

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit.

Përsa i përket krijimit të bazës së të dhënave e prioritizimit, është ngritur inventari i plotë me të dhëna të detajuara për 3500 km, të identifikuar si segmentet kryesore të rrjetit rrugor rural. Këto segmente rrugore janë përzgjedhur nga secili Qark në bazë të prioriteteve e të shpenzimeve aktuale të mirëmbajtjes. Janë mbledhur të dhëna të hollësishme për të gjithë seksionet rrugore, (rreth 525 segmente) si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon si edhe varfëria në zonë. Është bërë një analizë shumë kriterëshe për secilin nga këto seksione, e përbërë nga disa komponentë. Gjatë vitit 2010, ka filluar puna për përgatitjen e fazës së dytë të inventarizimit që parashikohet ta çojë numrin e km të inventarizuara në rreth 6200 Km. Për këtë qëllim janë rishikuar të dhënat e inventarit të hedhura në ROMAPS nga Roughton sipas Qarqeve duke i krahasuar me të dhënat e mbledhura nga inspektorët e FSHZH.

Gjithashtu ka vijuar puna për përgatitjen e një baze të dhënash për të percaktuar klasifikimin funksional të rrugëve, proces pune që është në vazhdim.

Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve përfituese për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të reja, po vazhdon trajnimi i tyre nga stafi i FSHZH-së.


Gjatë këtij viti janë trajnuar 258 komuna e bashki si dhe përfaqësues të qarqeve, në total rreth 474 persona.

Gjithashtu për llogari të këtij programi, në kuadër edhe të nismës së Qeverisë për të lidhur me rrugë asfaltike të gjitha qendrat e Komunave, është hartuar një bazë e vecantë të dhënash për gjendjen së rrugëve që lidhin qendrat e Komunave me rrugët nacionale apo rajonale.

Të dhënat e gjendjes fizike së këtyre rrugëve janë marrë nga inspektorët rajonalë dhe janë përpunuar nga Njësia e Mbështetjes Teknike në një bazë të dhënash.

Komponenti i dytë – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale dhe lokale.

11 projektet e financuara nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe OFID (OPEC) me një gjatësi prej 110 km, janë të realizuara në masën 98%. Aktualisht punimet kanë përfunduar për 10 rrugë në Qarqet, Fier, Tiranë, Dibër, Lezhë, Vlorë, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër dhe Berat. Ndërkohë pritet që gjatë vitit 2011, të



përfundojnë punimet në rrugën “Domaj – Ura e Lapajve”, në Qarkun Kukës.

Nga projektet e mësipërme 4 janë financuar nga Banka Botërore dhe 7 nga OFID.

Deri në Dhjetor 2010, shuma e kontraktuar për 4 rrugët e financuara nga Banka Botërore, dhe Qeveria Shqiptare, është 870,422,412 Lekë.

Shuma e kontraktuar për 7 rrugët e financuara nga OFID (OPEC), shkon në vlerën 1,577,291,677 Lekë.



Gjithashtu me ritme të kënaqshme po vazhdon edhe implementimi dhe financimi i 225.5 km rrugë rajonale që kryesisht janë vazhdim i segmenteve rrugore të fazës së parë si dhe segmente të reja financuar nga Banka e Këshillit të Europës (CEB). Nga 27 projekte të financuara nga ky donator, 9 rrugë kanë përfunduar punimet, dhe vijon puna për zbatimin e 18 segmente të tjera rrugore. 11 projekte janë kontraktuar dhe kanë filluar zbatimin që në vitin 2009, 11 projekte të tjera janë kontraktuar dhe kanë filluar zbatimin gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2010, ndërkohë që 5 projekte kanë filluar zbatimin e punimeve civile gjatë muajit Korrik 2010.

Shuma e kontraktuar për 27 rrugët e financuara nga CEB, është 5,538,898,421 Lekë.

Në kuadër të financimeve të bëra nga Programi IPA 2008, janë në proces zbatimi 34 km rrugë, ose 4 segmente rrugore të cilat kanë avancuar me ritme të kënaqshme, dhe pritet të përfundojnë në Shkurt 2011.

Në muajin Shtator 2010, është miratuar edhe një shtesë kontrate për 3,5 km të cilat janë pjesë e rrugës “Ish SMT – Rrilë – Shënkoll”. Kjo rrugë pritet të përfundojë në Qershor 2010. Deri, në fund të muajit Dhjetor 2010, është realizuar 87 % e punimeve civile, dhe është disbursuar 62 % e vlerës së kontratës.


Shuma e kontraktuar për 4 rrugët e financuara nga IPA 2008, shkon në vlerën 7,423,089 Euro.




Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qenë pozitive dhe mund të thuhet se standartet e reja të aplikuara në këtë projekt po japin rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve.

Gjatë vitit 2010 kanë përfunduar punimet në 19 kontrata, pjesë e investimeve të fazës së parë & të dytë:


1. Qarku Fier: Segmenti rrugor Strum - Qafa e Marinzes, 12.6 km




2. Qarku Gjirokastrër: Segmenti rrugor Valare-Erind, 5.4 km



3. Qarku Korçë: Segmenti rrugor Lapidar – Koritë, 10.5 km




4. Qarku Tirane: Segmenti rrugor Ura e Farkes- Qender Fshat, 6.6 km




5. Qarku Elbasan: Segmenti rrugor Belsh – Fierze, 9.0 km




6. Qarku Berat: Segmenti rrugor Ura e Gorices - Fshat Mbreshtan, 7.8 km





7. Qarku Korçe: Segmenti rrugor Koritë - Liqenas, 9.3 km




8. Qarku Fier : Segmenti rrugor Ballsh - Aranitas, 6.7 km




9. Qarku Shkoder: Segmenti rrugor Vau i Dejes-Nenshat, 11.7 km




10. Qarku Lezhe : Segmenti rrugor Lezhe-Kallmet, 12.75 km




11. Qarku Vlore : Segmenti rrugor Xarre-Fshati Pllake, 10.9 km




12. Qarku Shkoder : Segmenti rrugor Kallmet-Nenshat, 8.75 km




13. Qarku Fier : Segmenti rrugor Sheq-Marinze, 8.75 km




14. Qarku Vlore : Segmenti rrugor Pllake-Cuke, 11.5 km




15. Qarku Elbasan : Segmenti rrugor Fierze – Kosove, 8.7km




16. Qarku Diber : Segmenti rrugor Kuben –Perroi i Kapsit, 9,8 km




17. Qarku Durres : Segmenti rrugor Shijak – Maminas, 5 km



18. Qarku Durres : Segmenti rrugor Bubq - Ishem, 13.4 km



19. Qarku Fier: Segmenti rrugor Kryqezimi Grabian – Autostrada Lushnje, 4.3 km



Prokurimi

Procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”.

Rrugët e financuara nga Banka Botërore, GoA, OFID, dhe CEB, janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”.

Ndërkohë prokurimi i punimeve civile për rrugët e financuara nga IDB, do të kryhet sipas metodës “tender i hapur kombëtar”.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2010 janë mbyllur procedurat e tenderimit dhe janë lidhur 12 kontrata të punimeve civile me vlerë të përgjithshme prej 2,642,082,210 Lekë.

Gjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2010, ka përfunduar përgatitja e dokumentacionit teknik dhe është bërë shpallja e tenderave për punime civile për 24 segmente të reja rrugore, të financuara nga IDB, CEB, OFID, IEB dhe IBRD.

Supervizimi i kontratave të punimeve civile

Kompania Louis Berger SAS e cila është e kontraktuar për supervizimin e të gjitha punimeve civile, aktualisht po kryen supervizimin e implementimit të 19 kontratave të punimeve, të cilat janë bazuar në FIDIC.

Procedurat mjedisore

Në kuadrin e projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, ka vazhduar paralelisht edhe ndjekja e procedurave mjedisore sic parashikohen në Manualin e

Procedurave dhe në kërkesat e projektit. Gjatë këtij viti janë zhvilluar këto aktivitete të lidhura me mjedisin:

- Janë hartuar 15 Plane të Menaxhimit të Mjedisit të rrugëve;
- Është kryer kontrolli i raporteve periodike të Kompanive të Supervizionit për zbatimin e masave të propozuara nga projektuesi në lidhje me Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM) në projektet e supervizuara prej tyre;
- Është kryer kontrolli në terren i zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mjedisit me anë të vizitave të shpeshta për secilin nënprojekt dhe është plotësuar lista përkatëse e kontrollit ;
- Eshtë kryer kontrolli i Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), të kryer nga specialistë të licensuar të mjedisit ;
- Eshtë kryer dizenjimi i termave të references, në bashkëpunim me donatorin (JICA) për 4 paketa rrugësh për hartimin e Vleresimeve të Ndikimit në Mjedis;
- Pjesëmarrje në dizenjimin e termave të referencës për nënprojektet e reja të planifikuara (EBRD/EIB), në lidhje me përmbushjen e kriterëve mjedisore;
- Sesione diskutimi me MMPAU dhe QKL për lehtësimin e procedurave mjedisore në ndihmë të NJQV-ve. (tipi i lejes, raporti VNM, tarifa etj.);
- Pjesëmarrja në Konsultimin me Publikun të Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të kryer nga specialisti i licensuar i mjedisit;
- U është dhënë asistencë NjQV-ve për plotësimin e dosjeve për aplikimin në QKL;
- Është hartuar, në bashkëpunim me Departamentin e Planeve të Zhvillimit dhe kompaninë konsulente të zgjedhur, Plani i Veprimit për Shpronësimet dhe Raporti i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Urën e Velabishtit, pjesë e nënprojektit Ura e Gorices-Fshat Mbreshtan. Sapo të merret aprovimi (no-objection) nga Banka Botërore për këtë plan do të punohet me Njësinë e Qeverisjes Vendore për përgatitjen e dosjes së shpronësimit;

Konkluzione:

Projekti ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij. Aktualisht janë financuar 66 segmente rrugësh dytësore & lokale me një gjatësi totale prej 603 km, prej të cilave 19 segmente rrugore kanë përfunduar, dhe 23 të tjera janë në proces zbatimi. Ndërkohë 24 rrugë janë në proces tenderimi. Ndërkohë janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik 49 segmente të tjera rrugore në të gjithë vendin.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryeje me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të këtij programi, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Përveç fondeve të cilat janë në implementim, gjatë këtij viti është aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë një kredi prej 50 milionë Euro nga EBRD, dhe 50 milionë Euro nga EIB, të cilat janë pjesë e një paketë prej 137 milionë Euro ose 180 milionë USD financuar edhe nga IPA 2010-2011 dhe Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Banka Islamike për Zhvillim (IDB), është bërë gjithashtu pjesë e financimit të programit me 40 milionë USD. OFID ka financuar për herë të dytë këtë program me 10 milionë USD. Deri në Dhjetor 2010, Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, ka në proces zbatimi një fond prej 296 milionë USD.

Në muajin Dhjetor 2010, u nënshkrua marrëveshja me KfW, për financimin e Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale, dhe Programin e Ujësjetësive Rurale, në vlerën 20 milionë Euro. Këtij financimi do ti bashkohet dhe IPA 2009, me shumën 8.8 milionë Euro. Pjesë e grupit të donatorëve që janë angazhuar për t'iu bashkangjitur programit është edhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Nderkombëtar, JICA, IPA 2010 – 2011, etj.

Si rezultat i suksesit të implementimit të këtij programi dhe interesit në rritje të donatorëve, është tejkualuar ndjeshëm, shuma e parashikuar prej 400 milionë USD.

2.2 Programi “Punët në komunitet III” financiar nga CEB

Programi “Punët në komunitet III” financohet nga CEB në vlerën 14.38 milionë Euro, dhe ka si qëllim të nxisë zhvillimin social ekonomik të zonave rurale të vendit, të cilat kanë potenciale të zhvillimit ekonomik, veçanërisht në turizëm.


Në program janë përfshirë 16 komuna, të cilat janë të shpërndara gjeografikisht, dhe kanë tipare të veçanta të turizmit (komunat aplikojnë forma të ndryshme të turizmit bregdetar, malor, historik, eko-turizëm, agroturizëm, etj), dhe nevoja të ndryshme në aspektin e ndërtimit të kapaciteteve. Programi ofron asistencë teknike të diversifikuara që ndryshon nga komuna në komunë dhe përshtatet në përputhje me nevojat që përballen stafi dhe të zgjedhurit lokalë në secilën prej tyre.

Programi është i lokalizuar në NjQV-të si vijon: Drenovë, Tregan, Fushë-Kuqe, Orikum, Qendër Vlorë, Dermenas, Kryevidh, Petran, Kutalli, Ulëz, Ishëm, Margegaj, Postribë, Velipojë, Rrashbull, Petrelë.

Gjatë vitit 2010, programi “Punët në Komunitet III”, paraqet një ecure të kënaqshme në të dy komponentët e tij, si në asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve ashtu edhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës.

Në fazën e parë u identifikuan komunat të cilat kanë një plan zhvillimi lokal, të hartuar qoftë me FSHZH-në, qoftë me ndonjë organizatë tjetër. Në bazë të këtyre planeve u identifikuan projekte infrastrukturore të cilat u financuan nga programi.

Nga diskutime me të zgjedhurit lokalë u identifikuan NjQV-të, të cilat kishin nevojë për hartimin e një plani zhvillimi lokal. Si rezultat, pesë NjQV u përfshinë në procesin e hartimit me pjesëmarrje të planit të zhvillimit lokal. Këto NjQV janë: Tregan, Fushë-Kuqe, Kutalli, Drenovë dhe Orikum.




Gjithashtu u identifikuan NjQV-të, të cilat vlerësojnë si prioritare hartimin e një plani hapësinor dhe këto janë: Ulëz, Petrelë, Velipojë.

Katër NjQV të tjera identifikuan si prioritare hartimin e një plani zhvillimi të turizmit. Këto janë: Ishëm, Kryevidh, Qendër Vlorë, Petran.

I – Faza e parë

16 projektet që i përkasin kësaj faze kanë përfunduar gjatë vitit 2009. Nga këto 10 objekte kanë përfunduar periudhën e garancisë, dhe 6 objekte e tjera janë ende në periudhën e garancisë. Këto objekte mbikqyren për identifikimin e defekteve të mundshme nga stafi i FSHZH-së dhe administrata e NjQV-ve përkatëse.




Vlera e kontraktuar e punimeve civile për fazën e parë është 492,606,328 Lekë.

II – Faza e Dytë

Për fazën e dytë janë përzgjedhur dhe kontraktuar 14 projekte gjatë vitit 2009. Nga këto gjatë vitit 2010 janë finalizuar dhe kanë përfunduar periudhën e garancisë 4 objekte.

Ndërkohë kanë hyrë në periudhë garancie 9 objekte, ndërsa 1 objekt është ende në zbatim. Gjatë këtij viti, ecuria e punimeve ka qenë e kënaqshme, si rezultat i angazhimit të madh të kontraktorëve, dhe stafit të FSHZH. Si rrjedhojë, objektet në komunat Petran, Dermenas, Margegaj (Kocanaj), Postribë, Petrelë, dhe Orikum (Dukat) kanë përfunduar. Ndërsa në objektin e Komunes së Rrashbullit, vijon puna për zbatimin e punimeve civile.




Vlera e kontraktuar e punimeve civile për fazën dytë është 733,414,451 Lekë.

III – Faza e tretë

Në këtë fazë janë përzgjedhur 9 objekte. Gjatë këtij viti janë përgatitur projektet teknike, ka përfunduar procedura e tenderimit & kontraktimit, dhe kanë filluar nga puna për zbatimin e punimeve civile të gjitha objektet sipas planifikimit.

Deri në Dhjetor 2010, kanë përfunduar 7 objekte të kësaj faze.

Në 2 objektet e tjera vijon puna për zbatimin e punimeve civile.



Vlera e kontraktuar e punimeve civile për këtë fazë është 461,208,672 Lekë.

IV- Faza e katërt

Për këtë fazë janë përzgjedhur 6 objekte, nga të cilët objekti në komunën Orikum ka përfunduar, 3 objekte janë në proces zbatimi, 1 objekt është në proces kontraktimi, dhe 1 objekt është në proces tenderimi.

Përfunduar dhe është në periudhë garancie :

- 1- "Sistemim – asfaltim i rrugës Orikum – Tragjas", Bashkia Orikum;

Në zbatim:

- 1- "Sistemim – asfaltim i rrugës Gorre – Gurëz", Komuna Fushë – Kuqe;
- 2- "Rikonstruksioni i qendrës së Kalasë së Drishtit", Komuna Postribë;
- 3- "Sistemimi i kanalit të ujrave dhe lulishte, Tregan Qendër.

Në kontraktim :

- 1- "Ndërtimi i rrugës së Boboshtices", Komuna Drenovë

Në tenderim:

- 1- "Rikonstruksioni i rrugës Shetaj – Kisha Skenderbej", Komuna Ishëm

Shuma e kontraktuar deri në Dhjetor 2010, për këtë fazë, është 247,662,665 Lekë.

Për sa i përket përgatitjes së projekteve dhe dokumentacionit teknik për prokurimin e segmenteve të reja, është kryer kontrolli i projekteve teknike dhe gjithë preventivave të projekteve të ardhura. Në vijim janë kryer lëvizjet në terren për të verifikuar përshtatjen e projektit me terrenin.

Të gjitha objektet e financuara në kuadër të këtij projekti, janë me cilësi dhe të vlerësuara pozitivisht nga komunitetet përfituese. Është treguar kujdes i veçantë, për inspektimin e punimeve, jo vetëm nga supervisorët e kontraktuar, por edhe stafi teknik i FSHZH. Nga ana tjetër i është kushtuar vëmendje e veçantë, përgatitjes së projekteve teknike, duke i plotësuar ato me detajet e nevojshme. Për objektet e përfunduara, ka vijuar puna për sensibilizimin dhe marrjen e masave nga Komunitatet përfituese, për një mirëmbajtje sa më të mirë dhe efikase të objekteve pas përfundimit të tyre.

Prokurimi

Procesi i Prokurimit të punimeve civile është drejtuar dhe ka qenë nën përgjegjësinë e Komunave pjesëmarrëse në program. FSHZH ka ndjekur nga afër dhe ka miratuar zbatimin e procedurave të tenderimit për të gjitha kontratat e realizuara. Monitorimi i procesit të prokurimit për këto kategori, ka treguar se procesi ka qenë transparent dhe korrekt, në përputhje me procedurave ligjore në fuqi. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2010, janë tenderuar dhe kontraktuar 13 kontrata, me vlerë 566,454,194 Lekë.

Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Punët në Komunitet III”, janë kryer këto aktivitete:

- Hartimi i Planeve të Masave Zbutëse Mjedisore për të gjitha nën-projekte.
- Kontrolli i statusit të dokumentave mjedisore për secilën rrugë, ndihmesa dhe ndjekja e procesit të përfitimit të dokumenteve të nevojshme (leje, etj) në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e donatorit.
- Pjesëmarrja në Konsultimin me Publikun mbi Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të kryer nga specialisti i licensuar i mjedisit.
- Asistenca e dhënë NjQV-ve për plotësimin e dosjeve për aplikimin në QKL.
- Në mënyrë specifike, është ndjekur miratimi i lejes mjedisore për nënprojektin “Ndërtimi i Qëndres Turistike në Valbonë”, e cila u kushtëzua nga miratimi i Planit të Rregullimit të Territorit nga KRrTRSH.

Planet e Zhvillimit Lokal

Në kuadër të programit “Punët në Komunitet III”, Departamenti i Zhvillimit Rajonal në periudhën Janar-Dhjetor 2010 planifikoi dhe u ofroi asistencë teknike 16 NjQV-ve të përfshira në këtë projekt. Gjithashtu, gjysma e dytë e vitit 2010 shënon edhe ofrimin e dy llojeve të reja asistence teknike për NjQV-të. Këto forma të reja asistence kanë të bëjnë me hartimin e një plani rajonal si dhe të një plani investimesh kapitale, eksperiencia këto unike në tërësinë në aktivitetin të FSHZH-së.

Procesi i planifikimit të zhvillimit lokal në kuadër të projektit “Punët në Komunitet III” përfundoi në muajin Nëntor 2009, me miratimin e planeve strategjike nga këshillat e komunave. Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm zbatimin e këtyre planeve, i është kushtuar një vëmendje e veçantë vazhdimin të ofrimit të asistencës teknike dhe zbatimit të këtyre planeve të hartuara nga ana e NjQV-ve.

Për të asistuar NjQV-të e përfshira në këtë projekt, për të ngritur kapacitetet e tyre në drejtim të zbatimit të PZHL-ve, FSHZH nëpërmjet Departamentit të Zhvillimit Rajonal krijoi së pari një modul trajnimi në lidhje me zbatimin e PZHL-ve dhe më pas ofroi trajnime për stafin kyc të NjQV-ve të përfshira në program.

Moduli i trajnimit konsiston në katër temat e mëposhtme:

- Buxhetimi i PZHL-ve dhe Programe Buxhetore Afatmesme në nivel vendor;
- Performanca në nivel vendor: monitorimi i zbatimit të PZHL-ve;
- Plani i Investimeve Kapitale;
- Projektet në nivel lokal; Fondi i Zhvillimit Rajonal;

Trajnimi pati si synim që në përfundim të tyre, stafet lokale të komunave pjesëmarrëse të jenë të afta të përfshijnë objektivat dhe projektet e identifikuar në PZHL-të, në Programe Buxhetore Afatmesme (PBA). Gjithashtu vëmendje i është kushtuar edhe rritjes së standarteve të caktuara të performancës në nivelin lokal duke lidhur anën financiare me dokumentat teknike të hartuara në kuadrin e Planeve të Investimeve Kapitale. Në përfundim të trajnimeve, NjQV-të janë gjithashtu të informuara me gjerësisht në lidhje me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve dhe njohin më mirë praktikën e aplikimit për këtë instrument të rëndësishëm.

Në trajnim morën pjesë 5-7 punonjës të administratës së cdo komune, rreth 100 pjesëmarrës në total. Në përfundim të trajnimit 2 ditor, pjesëmarrësit u pajisën me certifikatën e pjesëmarrjes.

Hartimi i Planit të Zhvillimit Ndërkomunal, rajoni Zadrimë.

Periudha Qershor – Dhjetor 2010 përfshin një periudhë intensive në të cilën janë kryer shumica e aktiviteteve që shoqëron procesin e hartimit të Planit Ndërkomunal, Zadrimë. Disa prej aktiviteteve më të rëndësishme të procesit janë: takime prezantuese me aktorët kryesorë me qëllim marrjen e angazhimit lokal; nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit; krijimi dhe trajnimi i grupit të PZHN-së (grupi i planit të zhvillimit ndërkomunal); mbledhja e informacionit për analizën e situatës nëpërmjet focus grupeve me aktorë të ndryshëm, pyetësorit të komunës, analizës SWOT, analizës PEST, etj; sintetizimi i gjithë informacionit dhe hartimi i *Paketës Informative*; Sesioni i vizionimit dhe strategjizimit.

Aktualisht, grupet e punës (Komitetet e Zhvillimit Ekonomik, Zhvillimit Social, Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike; Mirëqeverisjes) po punojnë me hartimin e planit të veprimit në secilën fushë.

Aktivitetet e tjera të procesit që janë planifikuar për periudhën Janar - Mars 2011 janë: finalizimi i profilit të rajonit Zadrimë dhe plani i veprimit; prezantimi i drafit të PZHN-së tek aktorët për të marrë feedback-un e tyre; aprovimi i PZHN-së në bordin e ndërkomunales dhe në përfundim botimi i këtij dokumenti. Botimi i këtij dokumenti do të shoqërohet edhe me aktivitete të tjera promovuese me qëllim rritjen e vizibilitetit të këtij plani ndërkomunal.

Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale në Komunën Rrashbull është një tjetër formë e asistencës teknike që FSHZH ofron nëpërmjet Departamentit të Zhvillimit Rajonal. Roli i DZHR në këtë proces është udhëheqës, mbështetës dhe konsultues. Për këtë qëllim është hartuar një metodologji e thjeshtë e cila përmban hapat kryesorë të procesit dhe kalendarin kohor për përmbushjen e secilit prej tyre. Mesi i muajit Qershor shënon edhe fillimin e projektit.

Me qëllim harmonizimin e dokumentit të PIK-ut me strategji të tjera u organizuan takime dhe kërkesa informacioni nga Këshilli i Qarkut Durrës, Departamenti i Bujqësisë në Durrës, u studiua Strategjia e Zhvillimit të Transportit si dhe Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU) 2007 – 2013.

Duke pasur si qëllim një gjithëpërfshirje të nevojave të të gjitha fshatrave është proceduar me mbledhjen e të dhënave duke u nisur nga nevojat e evidentuara nga kryetarët e fshatrave.

Hapa të tjerë që janë ndjekur kanë qenë:

- Analiza e kriterëve për prioritarizimin e projekteve dhe përcaktimi i pesë kriterëve më kryesore prej tyre, duke analizuar mendimet dhe preferencat e një grupi të gjerë aktorësh të interesuar drejtpërdrejt për PIK Rrashbull,
- mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e një analize financiare, mbi bazën e informacionit të ofruar nga Stafi i Komunës,
- përgatitja e fishave të pjesës më të madhe të projekteve të veçanta,
- përmbledhja e të gjithë materialit të grumbulluar dhe paraqitja e të gjithë hapave të ndjekura duke mbledhur edhe mendimet dhe vërejtjet e përfaqësuesve të Komunës,
- së fundmi fillimi i përgatitjes së draft materialit përfundimtar dhe hyrja në fazën përfundimtare të finalizimit të PIK-ut.

Aktiviteti tjetër: Përfundimi i materialit të Planit të Investimeve Kapitale, aprovimi në Këshillin Komunal dhe botimi i tij deri në fund të Shkurtit 2011.

Publikimi i Planeve Lokale të Zhvillimit

Gjatë 6 mujorit të parë 2010 DZHR lehtësoi procesin e publikimit të planeve strategjike që u hartuan gjatë vitit 2009 në kuadër të projektit “Punet në Komunitet III”.

U publikuan pesë plane zhvillimi lokal të hartuara me asistencën e FSHZH-se. Ato janë:

- Plani i Zhvillimit Lokal, Komuna Tregan
- Plani i Zhvillimit Lokal, Komuna Kutalli
- Plani i Zhvillimit Lokal, Bashkia Orikum
- Plani i Zhvillimit Lokal, Komuna Drenove
- Plani i Zhvillimit Lokal, Komuna Fushe Kuqe

Gjithashtu, u publikuan katër strategji zhvillimi të turizmit nga katër organizata të kontraktuara dhe të asistuar nga FSHZH. Ato janë:

- Plani i Zhvillimit të Turizmit, Komuna Kryevidh
- Plani i Zhvillimit të Turizmit, Komuna Ishëm
- Plani i Zhvillimit të Turizmit, Komuna Qendër Vlorë
- Plani i Zhvillimit të Turizmit, Komuna Petran

Gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjitha NjQV-të e lartmendura u pajisën me planet përkatëse.

Konkluzione:

Programi “Punët në Komunitet III”, paraqet një ecuri të kënaqshme në të dy komponentët e tij, si në asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve ashtu edhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës. Ky projekt ka konsoliduar zhvillimin e qëndrueshëm të 16 komunave duke i pajisur ato me Plane Zhvillimi, si dhe duke i mbështetur këto plane me projekte të rëndësishme infrastrukturore. Për sa i përket komponentit të infrastrukturës, konstatohet se objektet e përfunduara janë me cilësi dhe të pëlqyeshme nga komuniteti përfutës. Vlerësojmë se duhet përshpejtuar puna për të finalizuar objektet e fazës së katërt, brenda afateve të parashikuara në projekt.


2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW

Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW, konsiston në ndërtimin e rreth 28 skemave të ujësjellësave rurale në 50 fshatra në Qarqet Diber, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së 40.000 - 50.000 banorëve. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2014. Vlera e programit është 9 milionë Euro (7.5 milionë + 1.5 milionë) për masat investuese dhe 1 milionë Euro Grant për ngritje kapacitetesh (masat shoqëruese).

PUR gjatë vitit 2010 ka hyrë në fazën e implementimit të Programit dhe në muajin Dhjetor janë shpallur tenderat për zbatimin e punimeve civile për 3 skemat e para të ujësjellësave, në Komunën Qendër të rrethit Malësi e Madhe (Qarku Shkodër), në Komunat Frankth dhe Batër të rrethit Mat (Qarku Diber), dhe në Komunën Margegaj të rrethit Tropojë (Qarku Kukës).

Gjatë këtij viti, puna për zbatimin e këtij programi ka konsistuar në:

1. Identifikimin, përzgjedhjen paraprake të skemave pjesëmarrëse në projekt. Për këtë në bashkëpunim me konsulencën, u krye procesi i fizibilitetit, mbështetur në një metodologji pjesëmarrëse e cila u implementua me sukses nga FSHZH. Për këtë u morën në konsideratë një seri të dhënash social – ekonomike dhe teknike, të cilat finalizuan përzgjedhjen me objektivitet të 28



skemave fituese. Ky proces ka filluar gjatë vitit 2009 dhe ka përfunduar në fillim të vitit 2010.

Përvec fizibiliteteve (sociale, teknike, mjedisore) të kryera gjatë vitit 2009 në 61 fshatra (28 Komuna) nga ku rezultoi lista fizibël me 50 fshatra (24 Komuna). Gjatë 6 – mujorit të parë të 2010 u kryen fizibilitete të tjera në dy Qarqe të Programit, Kukës dhe Dibër që do të shërbejnë si kandidatë të mundshëm për tu financuar (nëse në ndonjë ose disa nga skemat e miratuara të Programit për tu financuar do të ndërpritet bashkëpunimi për arsye të ndryshme), si më poshtë :

- Komuna **Kastriot**: fshatrat Kishavec & Vakuf në Qarkun Dibër (1500 banore, 257€/banor);
- Komuna **Llugaj**: fshatrat Cërnice, Rragam, Llugaj, Bukovë, Dunish, Sopot, Babinë (2600 banore, ~300€/banor);
- Komuna **Bujan**: fshatrat Bujan, Dojan, Gri, Bllatë, Gri e Re (1600 banore, ~300 €/banor);
- Ujësjiellësi Rajonal **Derjan**: Komuna Derjan / Derjan, Zall Gjocaj, Lami Madh, Gjocaj, Dukagjin, Urxallë, Barbullej; Komuna Macukull / Macukull, Shqefen; Komuna Rukaj / Rukaj, Prell, Rrembull, Bruc, Lac, Urake (6900 banore, 293€/banor);
- Komuna Qendër Tomin: fshati Pilafe (zëvendësoi fshatin Bahutë);

2. Përzgjedhja e kompanive të Projektim – Supervizimit të ujësjiellësave.
Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dokumentat e tenderit dhe është zhvilluar tenderi për firmat e projektimit. Ka përfunduar procesi i tenderimit për Projektimin & Supervizimin, dhe është bërë shpallja e firmave fituese për projektimin e 26 skemave të ujësjiellësave të ndara në katër lote.
3. Bashkëfinancimi me 10 % nga komunitetet përfituese i skemave të ujësjiellësave pjesëmarrëse në projekt është një nga elementet e rëndësishëm të këtij projekti. Deri në Dhjetor 2010, kanë financuar 100 % të kontributit lokal, 23 Njësi të Qeverisjes Vendore, pjesëmarrëse në këtë program. Realizimi me sukses i bashkëfinancimit të programit nga NjQV-të përfituese, ka përmbushur objektivin e vendosur në fillim të vitit për përfundimin e këtij procesi brenda vitit 2010.
4. Projektimi i skemave të ujësjiellësave.
Pas përzgjedhjes së kompanive të projektim - supervizimit të punimeve, në muajin Prill 2010 ka filluar puna për hartimin e projekteve teknike të cilat do të hapin rrugë zbatimit të punimeve civile për ndërtimin e ujësjiellësave. Deri në Dhjetor 2010, janë dorëzuar projektet teknike finale për 21 skema ujësjiellësash, dhe janë drejt përfundimit edhe projektet e 5 skemave të tjera.
Në këtë fazë të projektit, i është kushtuar një kujdes i vecantë, këshillimit me publikun, ndërgjegjësimit dhe mobilizimit të përfituesve në përgatitjen e projektit teknik për 26 skemat e përzgjedhura.
5. Tenderimi dhe Zbatimi i punimeve civile. Përfundimi i procesit të projektimit, i ka hapur rrugën tenderimit të punimeve civile. Kjo fazë ka filluar gjatë muajit Dhjetor 2010 dhe përfshin të gjitha skemat që kanë plotësuar bashkëfinancimin e projektit

me 8 % të vlerës, pjesë e kontributit lokal. Në muajin Dhjetor janë shpallur tenderat për zbatimin e punimeve civile për 3 skemat e para të ujësjellësave, në Komunën Qendër të rrethit Malësi e Madhe (Qarku Shkodër), në Komunitat Frankth dhe Batër të rrethit Mat (Qarku Dibër), dhe në Komunitat Margegaj të rrethit Tropojë (Qarku Kukës). Pritet që tenderimi për të gjitha skemat pjesëmarrëse në program të përfundojë brenda tre-mujorit të parë të vitit 2011. Pranvera e vitit 2011 do të shënojë dhe fillimin e fazës së zbatimit të punimeve civile.

6. Informimi, mobilizimi dhe sensibilizimi i komunitetit. Gjatë vitit 2010 u krijuan 26 Grupe të Përfituesve të Ujit në nivel fshati dhe komune. Janë organizuar takime për të sensibilizuar komunitetin në përkrahje të PUR. Njëkohësisht është bërë identifikimi dhe adresimi i problemeve sociale në terren. Konsultimet me publikun kanë pasur në axhendën e tyre midis të tjerash diskutimin e Drafteve Teknike të Projektit, por edhe çështjet mjedisore. Përveç takimeve të drejtperdrejta informuese, janë përgatitur dhe shpërndarë materiale informative, të cilat kanë pasur në përmbajtje të tyre aspekte të ndryshme të zbatimit të programit.
7. Përgatitja e draft Manualit Përfundimtar të PUR (Manuali Tregtar dhe Financiar, Manuali i Funkcionimit dhe Mirëmbajtjes, Manuali i Programit, Strategjia e Komunikimit dhe Rritjes së Ndërgjegjësimit). Gjatë këtij viti në bashkëpunim me konsulentin e huaj është përgatitur Draft Manuali Përfundimtar i PUR, i cili pritët të aprovohet edhe nga KfW, së shpejti.
8. Prezantimi i Manualit Tregtar dhe Financiar të ujësjellësave (Financial & Commercial Manual) në katër komunitat e Programit: Hajmel, Shupenzë, Melan, Shkrel, dhe marrja e komenteve nga këto Komunitat mbi Manualin. Testimi i procedurave financiare dhe tregtare në këto komunitat krijoi mundësinë e aplikimit të manualit në terren, për të parë se sa efektiv do të jetë përdorimi i tij në të ardhmen, dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në funksion të përdorimit me sukses të tij në të gjitha skemat pjesëmarrëse.

Në vijim të punës për realizimin me sukses të projektit, gjatë vitit 2011, parashikohen një sërë aktivitetesh të rëndësishme. Disa nga aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë kohore janë :

- Përfundimi i dorëzimit të projekteve;
- Përfundimi i Tenderimit - fundi i tre-mujorit të parë;
- Përfundimi i punimeve për të gjitha projektet-fundi i vitit 2011;
- Aprovimi i Program- Manualit të përgatitur nga Konsulenti CES;
- Trajnim i komunave dhe përfituesve për tarifimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujësjellësave;
- Asistencë teknike dhe ligjore për Komunitat e përzgjedhura në procedurat e aplikimit për Licencë si Operatorë të Shpërndarjes së Ujit;
- Përgatitja dhe implementimi i fushatës sensibilizuese/ndërgjegjësuere për aspektet higjieno-sanitare gjatë përdorimit të ujit;
- Përgatitja e Bazës së të Dhënave me nevojat për ujësjellësë për programin SIF IV brenda tre-mujorit të parë 2011. Përgatitja e Long Listes për Projektet e SIF IV;
- Përgatitja e Short-Listes dhe realizimi i fizibiliteteve për projektet e saj dhe Lista Finale për investim;

- Fillimi i zbatimit dhe nënshkrimi i angazhimit paraprak për projektet fituese të SIF IV;

Prokurimi

Në muajin Dhjetor 2010, janë shpallur tenderat e parë për punimet civile të 3 loteve të para të ujësjellësave të financuar në kuadër të këtij programi. Procedurat e prokurimit për punimet civile do të kryhen sipas metodës “tender i hapur kombetar”.

Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Ndjekja e procedurave për marrjen e lejes mjedisore nga ana e Njësive të Qeverisjes Vendore.
- Eshtë kryer trajnimi i projektuesve për hartimin e PMZM.
- Eshtë asistuar Komuna Koplik, për hartimin e VNM, si shembull për një zonë të mbrojtur (Rezervat natyror i menaxhuar, kategoria IV e zonave të mbrojtura.)

Konkluzione:

Projekti ka avancuar me sukses në të gjitha fazat e implementimit të tij. Fillimi i procesit të tenderimit për 3 skemat e para, përfundimi me sukses i fazës së projektimit, realizimi i fushatës së informimit, sensibilizimit dhe mbështetjes institucionale, kanë krijuar një baze shumë të mirë, për zbatimin me sukses të këtij projekti, dhe terren të përshtatshëm për nisjen e fazës të zbatimit të punimeve civile.

2.4 Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare

Një tjetër program investimesh i FSHZH-së është edhe realizimi i investimeve në infrastrukturë, të financuara nga Qeveria Shqiptare.

2.5 Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA 2009)

Në kuadër të fondeve të arkorduara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2009 për përmirësimin e infrastrukturës lokale në Njësitë e Qeverisjes Vendore, është miratuar financimi i projektit: “Ndërtim i Urës së Lanes në Fshatin Mëzez”, Komuna Kashar, Qarku Tirane, si dhe “Ndërtimi i rrugës në Lagjen Protoduar”, Komuna Poshnje Qarku Berat. Objekti i Komunës Poshnje është mbyllur përfundimisht, ndërsa objekti i Komunës Kashar pritet të mbyllet në tre-mujorin e parë të 2011.

Konkluzione:

Projektet e programit të investimeve të Qeverisë Shqiptare janë projekte të identifikuar në kuadër të programeve të tjera të FSHZH-së, bazuar në kriteret dhe standartet e

specifikuara në manualin e procedurave. Projektet kanë pasur një ecuri të mirë dhe është synuar një implementim sa më i shpejtë i këtyre projekteve duke synuar rritjen e impaktit si dhe shtimin e numrit të këtyre projekteve në vite.

2.6 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastruktues Vendore

Edhe gjatë vitit 2010, FSHZH është angazhuar për vlerësimin teknik të projekteve të Infrastrukturës lokale, në ndihmë të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Gjatë muajit Prill – Maj u krye vlerësimi i të gjithë objekteve në vazhdim dhe në bazë të informacioneve të marra nga NJQV-të si dhe supervisorët e punimeve, u përgatit informacioni për statusin e avancimit financiar deri në Dhjetor të vitit 2009, si dhe avancimin fizik të punimeve deri në Prill të vitit 2010. Informacioni i përgatitur i është dërguar zyrtarisht Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Ministrisë së Financave.

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.11 datë 1.4.2010 për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve u krye vlerësimi teknik i projekteve për të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore që kishin aplikuar për fonde sipas Formatit nr.1. Në bazë të VKM nr. 135 datë 3.2.2010 “Për percaktimin e kriterëve për ndarjen e fondit për zhvillimin e rajoneve”, u bë dhe vlerësimi social-ekonomik i projekteve. Lista e projekteve të vlerësuara i është dërguar Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe Sekretariatit teknik në Ministrinë e Financave në datë 30 Qershor 2010.

Në kuadër të projekteve në vazhdim, bazuar në listën e sjellë nga Ministria e Financave, gjatë muajve Gusht – Shtator u krye mbledhja dhe përpunimi i informacionit nga NJQV-të për rreth 160 objekte. Ky informacion i është nisur zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

3.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare e vitit 2010 është bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi metoda e raporteve të këtyre dy moduleve ndihmon në seleksionimin e atyre treguesve të cilët pasqyrojnë në mënyrë realiste performancën e institucionit. Kjo analizë jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin (buxheti), kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë vitit 2010, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiare të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar i tij të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparence, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponenteve perkates: investime infrastrukture, administrim të brendshëm, asistence teknike, etj.

Gjatë kësaj periudhe, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 49 milionë USD ose në masën 93% kundrejt buxhetit vjetor. Gjatë këtij viti është ndjekur zbatimi i 77 kontratave për punime civile me vlerë rreth 10 miliardë Lekë, kryesisht rrugë, ku pjesën më të madhe rreth 8 miliardë Lekë e zenë kontratat e lidhura në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe rreth 2 miliardë Lekë kontratat e lidhura në kuadër të Programit të Puneve në Komunitet III.

Për realizimin buxhetor janë ndjekur me peripikmeri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna progresive të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomik - financiar dhe të performances së aktivitetit të FSHZH-se gjatë kësaj periudhe, si dhe një analize në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si edhe peshën specifike të kategorive dhe komponentëve të veçantë.

Të ardhurat e FSHZH-së

Gjatë vitit 2010 FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të 5 Programeve në zbatim.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” – financuar Banka Botërore, OFID, Banka e Këshillit të Europës, IDB, EIB, EBRD dhe Qeveria Shqiptare ;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale – financuar nga KfW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit direkt;
- Programi “Punët në Komunitet III” - financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare si dhe përfituesit direkt;
- Programet “Fondi i Investimeve Sociale II dhe III” – financuar nga KfW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit direkt;

- Programet e investimeve të financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë viteve 2006, 2007 dhe 2008,2009.
- Kontributi i komunave (përfituesit) në masën 10 % të vlerës së investimit si bashkëfinancim në projektet në zbatim që zbatojnë këtë kriter.

Disbursimi i Fondeve gjatë 2010 sipas Programeve

Gjatë këtij viti, në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 31.8 milionë USD sipas Programeve si më poshtë:

- Për programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale gjatë këtij viti janë disbursuar rreth 29.22 milionë USD nga të cilat IDA 3.29 milionë USD , OPEC 6.23 milionë USD,CEB 19.7 milionë USD.
- Për programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” KFW IV janë disbursuar 903 mijë USD.
- Për programin “Projekti i Puneve në Komunitet III “ CEB janë disbursuar 1.68 milionë USD.

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare për të gjitha projektet e reja dhe në vazhdim në komponentet Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën 12.06 milionë USD.

Te ardhura të tjera

Gjatë aktivitetit ekonomiko-financiar të saj, FSHZH realizon hyrje të vlerave monetare (të ardhura) në vlera të pakta nga aktivitetet dytësore si: shitje të dokumentave të tenderave, investime të likuiditeteve në Lekë (vendosje depozite me afat), të ardhura për shërbime të kryera nga institucioni si seleksionimi i projekteve për Grantet konkurrese, etj.


Gjatë këtij viti janë vendosur depozita me afat, 3 muaj dhe 6 muaj për fondet në Lekë përkohesisht të lira duke u ndjekur procedurat e përcaktuara në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv për përzgjedhjen e ofertës me të mirë ofruar nga Bankat të cilat operojnë sot në treg. Vlera e të ardhurave të perfituara gjatë këtij viti është rreth 166 mijë USD.

Nga shitja e dokumentave për tender janë realizuar rreth 74 mijë USD.

Gjithashtu gjatë këtij viti në kuadër të Projekteve të “Furnizimit me Ujë te Zonave Rurale” dhe “Punët ne Komunitetit III” janë arketuar direkt nga përfituesit rreth 1.68 milionë USD si kontribut i tyre në bashkëfinancimin e nënprojekteve.

Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitit 2010

Gjatë vitit 2010 FSHZH ka menaxhuar një fond prej 49 milionë USD, me një realizim financiar në masën 93 % të buxhetit vjetor 2010. Realizimi financiar paraqitet me poshtë i ndarë sipas komponentëve respektive:



Infrastruktura

Ky komponent përbën aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për rrugë, ujësjellës, shkolla, qendra komunitare dhe projekte të zhvillimit lokal. Si komponent është realizuar në një vlerë prej 43.94 milionë USD ose në masë prej 95% kundrejt buxhetit vjetor.

Tabela 2. Realizimi financiar për 2010 për kategorinë “Investime”

Programet	Realizimi në % kundrejt buxhetit vitit 2010	Realizimi në vlerë (shprehur në USD)
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH	23.28%	10,232,468
Përfituesit + Fonde FSHZH	1.54%	678,363
Punët në Komunitet III (CEB)	9.06%	3,987,842
Rrugët Dytësore dhe Lokale (IDA, OFID, CEB, OPEC)	65.82%	28,926,043
Projekti i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale KFW	0.30%	120,864
Totali	100%	43,945,580

Projektim Supervizimi

Ky zë është realizuar në vlerën 1,973 mijë USD ose në një masë prej 72 % kundrejt Buxhetit të vjetor 2010 (Aneksi 5.8).

Në këtë komponentet janë përfshirë rreth 1,476 mijë USD shpenzime për kontratën e supervizionit me kompaninë Louis Berger e cila kryen supervizionin e punimeve në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale, rreth 331 mijë USD shpenzime

për kontratat e projektim supervizionit në kuadër të Programit të Punëve në Komunitet III financiar 100% nga Qeveria Shqiptare si dhe rreth 166 mijë USD në kuadër të Programit të Furnizimit me Uje te Zonave Rurale – KFW. Në këtë zë përfshihen të gjitha likujdimet e kryera në favor të kontraktorëve për projektimin e objekteve të reja si dhe për supervizionin e objekteve që janë në zbatim dhe në përfundim të punimeve.

Asistenca Teknike

Ky komponent është realizuar në vlerën 843 mijë USD ose në masen 75% kundrejt Buxhetit vjetor dhe përfshin konsulencë të huaj në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale në vlerën 266 mijë USD, në kuadër të Projektit të Furnizimit me Uje te Zonave Rurale, –KFW rreth 536 mijë USD, në kuadër të Projektit të Puneve në Komunitet – III financiar nga CEB Grant rreth 33 mijë USD si dhe 8 mijë USD të financuara nga fondet tona.

Kualifikime

Ky komponent përfshin shpenzimet e bëra për kualifikimin e stafit të FSHZH-së dhe të Komunave dhe Bashkive në përputhje me buxhetin e aprovuar. Ky zë është realizuar në vlerën 121 mijë USD ose në masën 80 % të buxhetit vjetor. Gjatë këtij viti në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet për kualifikimin e komunave për mirëmbajtjen e objekteve dhe ngritjen e kapaciteteve për kualifikimin e komunave, PZHL etj, në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe të Projektit të Punëve të Komunitetit –III në vlerën dhe për kualifikime dhe aktivitete të stafit brenda dhe jashtë vendit sipas tematikave të percaktuara në planet e punës vjetore respektivisht për administrimin e kontratave të FIDIC, për auditin e brendshëm, burimet njerezore, disbursimet, prokurimet, etj.

Pajisje

Kjo kategori është realizuar në vlerën 169 mijë USD ose në masën 47 % kundrejt buxhetit vjetor 2010. Në këtë zë janë përfshirë pagesat e bëra për dy makinat e prokuruar në vitin 2009 si dhe shpenzimet për blerje pajisje informatike, kompjutera, printera, skanera, aparate fotografike dhe up-grade i centralit telefonik së bashku me aparatet telefonike etj, për FSHZH në qendër dhe në rrethe.

Shpenzime operative

Shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 175 milionë Lekë ose rreth 91 % kundrejt buxhetit vjetor. Realizimi i zërave të shpenzimeve të nën-komponenteve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 3. Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2010.
Analiza e shpenzimeve të kosto operative**

BUXHET 2010 (Kosto operacionale) Lekë				
No	ZERAT	BUXHET 2010	Realizuar 2010	%
1	Kanceleri	2,500,000	2,355,226	94%
2	Karburant	7,000,000	4,620,055	66%
3	Servis makinash/siguracion	5,500,000	5,158,444	94%
4	Pagat	143,223,000	132,516,758	93%
5	Dieta	8,000,000	7,301,000	91%
6	Telefon dhe PT	5,000,000	4,215,231	84%
7	Internet	1,000,000	825,416	83%
8	Energji Elektrike/Uje	1,500,000	1,500,000	100%
9	Zyra me qera	1,000,000	1,000,000	100%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	2,800,000	2,794,801	100%
11	Te tjera/Petty cash	2,650,000	2,518,418	95%
12	Publikimi & Promovime	10,600,000	9,523,317	90%
13	Shpenzime gjyqesore	300,000	282,295	94%
14	Kontrata Sherbimi	1,000,000	1,000,000	100%
	TOTAL	192,073,000	175,610,961	91%

a. Shpenzimet për kancelari

Për vitin 2010 shpenzimet për kancelari janë realizuar në vlerën prej 2,355 mijë Lekë ose 94 % kundrejt buxhetit vjetor 2010. Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, mirëmbajtje të paisjeve kompjuterike, fotokopjeve, etj.

b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor i parashikuar për këtë zë të shpenzimeve ishte 7 milion leke, ose 3.65 % të buxhetit vjetor të kosto operative. Gjatë këtij viti rezultoi një realizim në masën 66 % kundrejt buxhetit vjetor. Realizimi në këtë zë ka ardhur si rezultat i problemeve të shkaktuara nga ndërprerja në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim e furnizimit me naftë nga kompania e kontraktuar dhe rimbursimit të vlerës së tollonave të bllokuara vetëm në ditën e fundit të vitit.

c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 5,5 milionë Leke, realizimi për vitin është rreth 5,158 mijë Lekë ose 94% kundrejt Buxhetit vjetor 2010.

d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2010 janë parashikuar në shumën 143 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masen 93 % kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbimet për vitin 2010 janë parashikuar me masen 8 milionë Leke. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 7,301 mijë Lekë ose 91 % kundrejt Buxhetit vjetor 2010. Ky zë shpenzimesh mbeshtet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikëqyrjen e objekteve në terren.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si edhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 5 milionë Lekë për vitin 2010 dhe është realizuar në vlerën 4,215 mijë Lekë ose 84% kundrejt Buxhetit vjetor. Këto shpenzime janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shpenzimet të tjera të aktivitetit në terren, pasi rritja e volumit të punës çon automatikisht në një shtim të nevojës për komunikim me partneret lokale dhe kontraktoret në funksion të realizimit të projekteve.

g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete rajonale të FSHZH-se, energji elektrike, ujë, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në buxhetin 2010 janë parashikuar rreth 8,950 milionë Leke. Ky zë është realizuar në vlerën 8,638 mijë Lekë ose 97% kundrejt Buxhetit vjetor 2010.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për reklama, spote publicitare e televizive, publikime të ndryshme në kuadër të promovimit të punës dhe imazhit të institucionit. Për këtë zë në buxhetin 2010 janë parashikuar rreth 10,600 mijë Lekë dhe realizimi i këtij zëri për vitin 2010 është në vlerën 9,523 mijë Lekë ose 90 % kundrejt Buxhetit vjetor 2010.

i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2010 janë parashikuar rreth 1,300 milionë Lekë dhe realizimi i këtij zëri për vitin 2010 është në vlerën 1,282 mijë Lekë ose 98.6 % kundrejt Buxhetit vjetor 2010.

3.2 Komunikimi dhe Informimi

Gjatë këtij viti, aktiviteti i sektorit të informimit dhe komunikimit është përqëndruar në realizimin e hapave të veprimit të parashikuara në strategjinë e komunikimit të institucionit të përgatitur në fillim të vitit 2010.

Nëpërmjet kësaj strategjie, FSHZH synon të ofrojë informacion për target grupe të ndryshme, duke përmirësuar marrëdhëniet me grupet e interesit, dhe veçanërisht me përfituesit dhe publikun e gjerë, duke nxitur më shumë veprim, të ndërtojë konsensus, të ndryshojë qëndrime, dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm.

Veçanërisht këtë vit është parë si një domosdoshmeri promovimi i aktivitetit institucional dhe impaktit të arritur nga investimet e kryera, duke qenë se viti 2010 është viti kur filluan të shfaqen rezultatet e para të programit më të madh të menaxhuar nga FSHZH, “Rrugët Dytësore dhe Lokale”. Niveli i financimeve, grupimi i madh i donatoreve, aktivitetet e ndërmarra, menaxhimi si edhe rezultatet e gjeneruara, janë impresionuese dhe do të vijojnë të kenë më shumë publicitet.

Organizimi i një fushate informative këtë vit për Programin e “Rrugëve Dytësore dhe Lokale” është mbështetur me financim edhe nga një Grant i Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim CEB.

Aktiviteti më i rëndësishëm që garantoj një njohje të gjerë të publikut me rezultatet e investimeve të kryera nga Qeveria Shqiptare, Institucionet financiare ndërkombetare nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, ishte realizimi dhe shfaqja e një cikli prej 21 dokumentarësh të shkurtër televizivë. Në këta dokumentarë pasqyrohen investimet që po kryen FSHZH dhe Qeveria Shqiptare për shumicën e rretheve, si edhe impakti i tyre i menjëhershëm në permiresimin e kushteve të jetesës. Nëpërmjet kontraktimit të një trupe profesioniste xhirimi, është arritur që krijohet një set informativ dokumentarësh ku ndërthuren vlerat artistike me ato dokumentare. Gjithashtu është përfunduar dhe një dokumentar i përgjithshëm ku paraqitet aktiviteti i FSHZH-së në total.

Dokumentarët filluan transmetimin e tyre televiziv në periudhën Shtator-Tetor në mediat lokale. (shih aneksin 5.10). Transmetimi televiziv, i cili u arrit në sajë të një bashkepunimi frutdhënës me televizionet lokale, ka garantuar mbulimin e plotë në nivel kombëtar duke ofruar për çdo komunitet informacione të personalizuara. Komentet e marra nga transmetimet e deritanishme tregojnë për një pritje pozitive të publikut, si edhe për një njohje dhe vlerësim të investimeve të kryera nga Qeveria Shqiptare dhe Investitorët ndërkombëtarë për zhvillimin e qëndrueshëm në vend. Gjatë muajit Nëntor 2010 Televizioni Publik Shqiptar ka filluar një cikël emisionesh për transmetimin të 21 dokumentareve të prodhuar, dhe do të zgjasë 21 javë.

Në përputhje me strategjinë e komunikimit, me synim rritjen e transparencës, përmirësimin e aksesit të publikut, dhe organizimin dinamik të informacionit, është ristrukturuar faqja zyrtare e internetit. Pasi kaloi një periudhë testimi, faqja zyrtare e internetit aktualisht është duke funksionuar normalisht. Struktura e përgatitur së bashku me arkivën e dokumentarëve të prodhuar, shërbejnë si material bazë nje CD multimediale, e cila do të shpërndahet në aktivitetet promovuese që do të organizohen në vijim.

Me qëllim shtimin e komunikimit me publikun e gjerë, rritjen e vizualitetit të arritjeve të FSHZH-së dhe investimeve të Qeverisë Shqiptare, në datat 25-29 Nëntor 2010, sipas planifikimit që në fillim të vitit, u krye pjesëmarrja në Panairin më të rëndësishëm që organizohet në vend, atë të Klik-Ekpo-Klik. Në stendën e FSHZH-së u ekspozuan pamje nga ndërtimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale, nga Punët në Komunitet III si dhe nga Programi i Ujësjiellësave i Ruralë. Gjatë këtyre 5 ditëve u shpërndanë materiale informative të institucionit, u vunë kontakte me persona të interesuar si dhe u shfaqën dokumentarët gjatë gjithë ditëve të qëndrimit në Panair.

Në datat 17-18 Nëntor 2010, Fondi Shqiptar i Zhvillimit mori pjesë në panairin e organizuar nga shoqatat e pushtetit vendor me temë “Qeverisja Vendore dhe Turizmi”. Ky panair organizohet me qëllimin e prezantimit të eksperiancave më të mira të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe agjencive shtetërore në fushën e zhvillimit të turizmit. FSHZH në stendën e tij prezantoi eksperiancën e saj në zhvillimin e turizmit, konkretisht investimet në infrastrukturën në shërbim të turizmit dhe në veçanti rezultatet e projektit “Punët në Komunitet III” projekt që lidhet ngushtësisht me zhvillimin e turizmit në 14 NJQV.

Gjatë projektit “Punet në Komunitet II” të financuar nga Banka Boterore, u ngritën dhe u pajisën gjashtë Qendra komunitare në komunat përfituese. Për këtë vit u planifikua që të organizoheshin aktivitete publike në bashkëpunim me grupet e interesit që frekuentojnë këto qendra. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është sensibilizimi i komuniteteve për të rritur pjesëmarrjen në aktivitetet e qendrave, forcimi i partneritetit me këto komunitete, si edhe dhënia e mesazheve informative. Për këtë arsye u organizuan gjatë muajve Maj-Qershor 2010 aktivitete promovuese në 4 prej 6 Qendrave Komunitare të ngritura në të gjithë Shqipërinë, përkatësisht në: Qendrën Komunitare Seman, Shënkoll, Gur i Zi dhe Bulgarec.

Këto aktivitete të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me Komunat e këtyre qendrave, konsistonin në shndërrimin e një ditë të zakonshme në një ditë feste për komunën, përfituesit e Qendrave Komunitare si dhe banorëve e zonës. Disa nga aktivitetet kryesore të këtyre ditëve ishin: Koncerte festive me pjesëmarrës grupet artistike të komunave, kengë, valle, recitime, konkurse, ekspozita punimesh me talente të komunës, si dhe aktivitete sportive si lojë voleybolli, shahu, futbollit etj. Për fituesit e kompeticioneve të ndryshme u shpërndanë dhe dhurata simbolike të përgatitura nga FSHZH. Në fund të çdo aktiviteti, nxënës të shkollave të mesme të çdo komune, të pajisur me mjetet e nevojshme organizuan një fushatë sensibilizuese për pastrimin e plazhit të Semanit e Shënkollit si dhe pastrimin e ambjentëve përreth Qendrës Komunitare në Komunën Gur i Zi dhe Bulgarec.

Pjesëmarrës në këto aktivitete ishin përfaqësues nga FSHZH, Deputetë, Kryetarë Qarqesh, Kryetarë Komunash, përfaqësues nga Drejtoritë Arsimore, banorë të zonës etj.

Pas rezultateve pozitive të aktiviteteve të hapura në komuna, u planifikua që një sistem i ngjashëm promovues të zhvillohej edhe në komunat që janë përfituese në kuadër të programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale. Komuna Kallmet ishte një nga Komunat e përzgjedhura për të kryer aktivitetin promovues në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore e Lokale. Për këtë aktivitet u organizuan programe të ndryshme kulturore-edukative nga nxënësit e shkollave të kësaj komune si dhe u zhvillua një fushatë sensibilizuese për sigurinë rrugore e mirëmbajtjen e saj.

Këto aktivitete u pasqyruan nga mediat lokale dhe kombëtare si dhe në web sitin e institucionit.

Gjatë këtij viti një sërë artikujsh janë botuar në median e shkruar si gazetat Koha Jonë, Shqip, Gazeta Shqiptare, Gazeta Republika, Revista Monitor etj, ku është paraqitur aktiviteti kryesor i FSHZH-së, ecuria e programeve individuale si edhe arritjet e deritanishme. Gjithashtu janë paraqitur kronika televizive në mediat kombëtare dhe lokale si TVSH, TV Klan, Top-Channel, Ora News, News 24, Rozafa Tv etj, mbi projektet që po zbatohen si edhe impaktin që ato do të kenë pas përfundimit.

Ka vazhduar publikimi në faqen e internetit i të gjitha lajmeve, njoftimeve dhe prokurimeve të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, si edhe ka pasur një ndërveprim aktiv në faqen e internetit përsa i përket aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.

Gjatë muajit Nëntor u realizua prodhimi i materialeve informative e promociionale mbi aktivitetin e përgjithshëm të FSHZH-së, programeve në zbatim etj.

3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi

Gjatë vitit 2010 ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së tre programeve kryesore në zbatim nga FSHZH.

Programi Punët në Komunitet III. Sektori i Monitorim – Vlerësimit ka ndjekur dhe monitoruar nga afër zbatimin e projektit në të gjithë komponentet dhe elementët e tij.

Objekti i punës së këtij sektori ka qenë monitorimi periodik i komponentëve kryesorë të projektit, financimi i nënprojekteve prioritare në infrastrukturë, ngritja e kapaciteteve dhe hartimi i planeve të zhvillimit lokal dhe sektorial.

Performanca e menaxhimit financiar, prokurimeve, zbatimit të punimeve civile, çështjeve të lidhura me mjedisin, rregullsia e dokumentacionit të dosjeve teknike, janë monitoruar përmes shqyrtimit të informacioneve dhe dokumentacionit në tavolinë, dhe kryerjes së vizitave në terren.

Disa nga aktivitetet kryesore të monitorimit të PPK III, kanë qenë:

- Raportimi periodik i ecurisë së programit për komponentët kryesorë të tij;
- Kryerja e vizitave në terren në të gjitha objektet, për të monitoruar ecurinë e zbatimit të punimeve civile;
- Kontrolli i dosjeve teknike të nënprojekteve të infrastrukture, për të parë rregullsinë e mbajtjes së dokumentacionit konform standarteve të miratuara;
- Monitorimi i procedurave të ndjekura për hartimin dhe zbatimin e 40 Planeve të Masave Zbutese Mjedisore; dhe takimeve konsultative me publikun për çështjet mjedisore;
- Monitorimi i të dhënave të përgjithshme të programit ;

Si konkluzion i monitorimit të ecurisë së programit, vërehet së performanca e tij është shumë e mirë në të gjithë komponentët përbërës të tij dhe ka plotësuar objektivat kryesorë të tij në përputhje me pritshmerinë e Donatorit.

Hartimi i raportit afatmesëm i vlerësimit të programit CW III

Ky dokument përmban një vlerësim të performancës afatmesme të aktiviteteve të kryera në kuadër të Programit « Punët në Komunitet III », për periudhen Dhjetor 2008 – Mars 2010. Raporti i monitorimit afatmesëm është pjesë integrale e punës së sektorit të Monitorim Vlerësimit në funksion të paraqitjes së gjendjes së ecurisë së programit dhe performancës së tij në të gjithë komponentet e tij, duke dhënë mundësinë e evidentimit të mangësive dhe përmirësimit të tyre gjatë aktiviteteve në vijim.

Monitorimi i ecurisë së **Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale** në të gjithë elementet e tij, ka qenë një ndër aktivitetet paresore të sektorit të Monitorim – Vlerësimit. Puna për monitorimin e programit ka konsistuar në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi ecurinë e nënprojekteve për të gjitha fazat e investimit dhe të gjithë Donatorët. Gjithashtu është verifikuar në terren ecuria fizike e punimeve, problematikat, zbatimi në terren i Planit të Masave Zbutese Mjedisore, si edhe është marrë perceptimi i komunitetit mbi një seri çështjesh të lidhura me zbatimin e projektit.

Janë shqyrtuar të gjitha raportet mujore periodike të hartuara nga supervizori Louis Berger SAS, dhe është bërë monitorimi i indikatorëve të ecurisë së projektit, si avancimi teknik dhe ai financiar.

Në fund të vitit 2010, vërehet një performancë shumë e mirë e programit në të gjithë elementët e tij.

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar Termat e Referencës për konsulencën e Vlerësimit të Impaktit të këtij programi të cilat janë konsultuar me Bankën Botërore. Njoftimi për shprehje interesi për shërbimin e konsulences pritët të shpallet në fillim të muajit Janar 2011.

Vlerësimi afatmesëm i ecurisë së Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale

Gjatë periudhës Shtator - Dhjetor 2010, me asistencën dhe ekspertizën e konsulencës së jashtme pranë Departamentit të Infrastrukturas, në kuadër të zbatimit të PRDL, u krye hartimi i raportit afatmesëm të ecurisë së programit. Ky vlerësim u krye për financimet e Bankës Botërore dhe OFID, për 11 rrugë dytësore dhe lokale, të financuara nga këta donatorë. Ky vlerësim dha një panoramë të qartë të ecurisë së projektit në këtë fazë të zbatimit të tij. Ai analizoi realizimin e objektivave të projektit, dhe performancën e komponentëve kryesorë të tij. Përmes këtij raporti u evidentuan arritjet dhe problematikat e hasura, gjatë zbatimit të projektit, dhe u sugjeruan rekomandime për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Raporti nxori në pah se deri në këtë fazë të zbatimit të tij, Projekti “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” ka qenë shumë i suksesshem në të gjithë komponentet e tij. Ky sukses ka ardhur si rezultat e punës shumë të mirë që është kryer nga të gjithë aktoret e përfshira në zbatimin e këtij projekti, dhe në mënyrë të vecante, FSHZH i cili ka angazhuar të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, për të arritur objektivat më të larta të programit. Standartet e aplikuara në realizimin e këtij projekti me përmasa kombëtare, kanë lejuar që rrugët e rikonstruara të jenë me cilësi të lartë, duke plotësuar pritshmëritë e perfituesve dhe të gjithë aktoreve të tjerë që kontribuojnë në implementimin me sukses të tij.

Ky vlerësim i parapriu Misionit të Bankës Botërore, i cili u krye gjatë muajit Dhjetor 2010. Misioni në fjalë, vlerësoi ecurinë e projektit në terma kohore afatmesme, duke shqyrtuar në detaje dhe më nga afër se misionet e zakonshme performancën e tij. Në fund të tij, misioni vuri në dukje se: “Progresi i Projektit Rrugët Dytësore dhe Lokale

mbetet shumë i mirë, me punime të përfunduara në 10 nga 11 seksionet rrugore. Seksioni i mbetur pritet të përfundohet brenda sezonit të ndërtimit të vitit 2011. Ndërkohe të gjithë treguesit e progresit të vitit të pestë të projektit janë arritur që tani.”

Vlerësimi i përfituesve

Gjatë periudhës Shtator – Dhjetor 2010, u krye hartimi i raportit të Vleresimit të Përfituesve. Objektivi i Vlerësimit të Përfituesve ishte vlerësimi i progresit dhe efektivitetit të PRDL, bazuar në opinionet dhe perceptimet e marra nga përfituesit e drejtpërdrejtë dhe aktorët e tjerë lokale. Ky vlerësim u krye në periudhën afatmesme të zbatimit të programit, dhe sherbeu për të vlerësuar shkallen e efektivitetit të projektit, dhe impaktin e menjëhershëm që ka sjellë ky program në përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve përfituese.

Për realizimin e këtij vlerësimi u përdor një set i diversifikuar mjetesh të cilët dhanë një panoramë të qartë të ndikimit të programit në jetën e banorëve përfitues. Gjithashtu ky vlerësim ndihmoi në evidentimin e problematikave të shfaqura dhe u krijoi mundësi vendim-marrësve, menaxherëve të projektit dhe Donatorëve, të përmirësojnë elementë të vecantë të tij, në të ardhmen.

Për realizimin e tij, u krye vërtetimi në terren, përmes intervistave individuale me përfitues të drejtpërdrejtë, dhe diskutimeve me fokus grupe, të cilat perfaqësuan grupime të vecanta përfituesish.

Njëkohësisht u hartua një pyetesor i cili në perberje të tij kishte çështjet thelbësore të lidhura me përfitimet e menjëhershme sociale dhe ekonomike të ardhura si rezultat i zbatimit të këtij programi, por edhe çështje të lidhura me performancën e tij dhe sugjerime për përmirësim në të ardhmen.

Puna vijoi me plotësimin në terren të 300 pyetesoreve të shtrire në komunitetet që kanë përfituar nga rikonstruksioni i 11 rrugëve të financuara nga Banka Botërore dhe OFID. Më pas u krye përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe u hartua raporti përfundimtar.

Ky vlerësim nxori në pah përfitimet që ka sjellë ky program për banorët e zonave rurale.

- 81 Komunitete ose rreth 95 mijë banorë përfitojnë drejtpërdrejt nga zbatimi i tij.
- Programi ka sjellë lehtësim dhe rritje të aksesit drejt shërbimeve jetësore, shëndetësi, arsim, treg.
- Rrugët janë të kalueshme në çdo kohë dhe koha e udhëtimit për në qytet është shkurtuar me 60 përqind.
- Banorët tashmë kanë mundësi të ulin kostot e prodhimit dhe të rrisin të ardhurat për familjet e tyre.
- Është përmirësuar ndjeshëm shërbimi i transportit publik, dhe janë përmirësuar kushtet e udhëtimit.
- Janë shtuar shanset për punësim dhe është rritur aksesimi drejt tregut të punës.

- Janë krijuar kushte optimale për hapjen e bizneseve të reja.
- Është rritur ndjeshëm ndërtimi i shtepive të reja.
- Është frenuar eksodi rural, dhe janë hapur perspektiva të reja për zhvillim të qendrueshëm të komuniteteve përfituese.

Rezultatet e nxjerra nga ky vlerësim, konfirmuan edhe një herë zbatimin me sukses të këtij programi i cili ka sjellë përfitime të mëdha për komunitetet përfituese.

Monitorimi i Projektit të Ujësjiellësave Ruralë ka ndjekur treguesit periodikë të komponenteve kryesore të projektit duke i krahasuar me planet e punës, dhe ka verejtur përgjithësisht një ecure të miire të këtij projekti.

Plotësimi i databazës së nënprojekteve të zbatuara nga FSHZH 1993 – 2010

Një aktivitet i rëndësishëm për sektorin e monitorimit ka qenë përmirësimi i databazës së nënprojekteve të infrastrukures të financuara nga FSHZH gjatë periudhes 1993 – 2010. Për këtë qëllim janë verifikuar, krahasuar dhe shqyrtuar mbi 1800 nënprojekte me 16 rekorde baze. Deri në fund të Dhjetorit 2010 janë kontrolluar, plotësuar, apo hedhur nga fillimi mbi 29 000 rekorde (të dhena) të cilat kanë pasur mangësi në zerat e verifikuar. Për shkak të datimit të hershëm të këtyre të dhënave, është punuar paralelisht me disa burime informacioni për të arritur nivelin e kërkuar të saktësisë së të dhënave. Për këtë qëllim janë shqyrtuar raporte vlerësimi të projekteve në vite dhe informacione pjesore të marra nga Departamenti i Financës, Departamenti i Infrastrukures, Njësia e Auditit të Brendshëm, dhe Arshiva.

Databaza e plotësuar ka përfunduar dhe është e gatshme për përdorim.

3.4 Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, zhvillon aktivitetin bazuar në planin vjetor të auditimit, si dhe në programet e aprovuara për çdo auditim të realizuar. Programet janë hartuar duke patur parasysh objektivat e FSHZH të përcaktuara për faza të ndryshme të implementimit të projekteve, metodën e vlerësimit të riskut për projektet dhe strukturat e përfshira në to.

